



Instituti Kërkimor për Çështje
Evropiane dhe të Zhvillimit

BULETIN INFORMATIV

Janar - Qershor
2019

VËLLIMI I

Përmbledhje

Instituti RIDEA ka mbuluar gjerësisht pro cesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Në terma konkret, ne kemi kryer dy (2) sondazhe brenda periudhës së këtij buletini, në lidhje me perceptimin e qytetarëve të Kosovës për skenarët e marrëveshjes eventuale midis Kosovës dhe Serbisë.

Njëlloj, kemi organizuar disa aktivitete në terren (konferenca, tryeza të rrumbullakëta, takime informuese, etj.), që kishin të bëjnë me dialogun e lehtësuar nga BE për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

***Ne besojmë në fuqinë
transformuese të
ideve dhe kreativitetit***



Zëri i Popullit rreth 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Nën organizimin e Institutit RIDEA, janë mbledhur rreth një tryeze liderët kryesor të pushtetit dhe opozitës për të diskutuar për - Zërin e Popullit rreth "Finales së Madhe" ndërmjet Kosovës dhe Serbisë-. Në këtë tryezë ishin pjesëmarrës presidenti Thaçi, Z. Albin Kurti nga LVV, Z. Lutfi Haziri nga LDK, zv. kryeministri Fatmir Limaj, profesorë nga Universiteti i Oxfordit, ambasadorë të ndryshëm nga vendet aleate të Kosovës, aktivistë të shoqërisë civile dhe përfaqësues nga bota akademike. Fillimisht, Profesori Anthony Heath nga Universiteti i Oksfordit prezantoi gjetjet e sondazhit, të cilat u diskutuan në detaje nga anëtarët e panelit. Pas fjalimeve të panelistëve, pjesëmarrësit e tryezës patën mundësinë të shtrojnë pyetje dhe të komentojnë gjetjet e sondazhit.

Trajnim në teknikat e intervistimit në terren

Në përputhje me sugjerimet dhe mbikqyrjen rigoroze të profesorëve të Universitetit të Oksfordit dhe me punën e palodhshme të programerëve vendor, të punësuar në kompani Amerikane, RIDEA ka krijuar platformën online për sondazhe. Përmes kësaj platforme, synohet sofistikimi i mëtejshëm i metodës së punës dhe rrjedhimisht rritja e saktësisë dhe precizitetit të gjetjeve duke përdorur, përveç tjerash, mekanizma si *GeoLocation collection & tracking*. Për këtë qëllim, kohë më parë është mbajtur trajnimi i anketuesve në përdorimin e tabletëve elektronik dhe mbi teknikat e zbatimit të sondazheve në terren mbi bazën e platformës online.



'Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Alternativat dhe Opsionet'

Më 6 mars 2019, në Prishtinë, nën organizimin e Institutit RIDEA është zhvilluar tryeza e diskutimit sipas modelit *Chantham House Rule* rreth alternativave dhe opsioneve të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një fjalë përshëndetëse në fillim të kësaj tryeze e ka mbajtur edhe Ambasadori Norvegjez në Kosovë, Z. Per Strand Sjaastad. Pjesëmarrja në tryezë ishte gjithëpërfshirëse, me figura politike si deputetë dhe udhëheqës të forumeve rinore, studiues dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile.

'Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Alternativat dhe Opsionet' - Tryezë diskutimi në Ferizaj

Më 13 mars 2019, në Ferizaj, nën organizimin e Institutit RIDEA është zhvilluar tryeza e diskutimit rreth alternativave dhe opsioneve të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pjesëmarrja ishte gjithëpërfshirëse, në tryezë ishin përfaqësues dhe udhëheqës lokal të partive politike, studiues dhe organizata lokale të shoqërisë civile.





‘Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: Alternativat dhe Opsionet’-Tryezë diskutimi në Gjilan

Më 22 mars 2019, në Gjilan, kemi zhvilluar diskutime interesante dhe produktive rreth dialogut Kosovë - Serbi. Një fjalë përshëndetëse në fillim të kësaj tryeze ka mbajtur dhe Ambasadori Norvegjez në Kosovë, Z. Per Strand Sjaastad. Pjesëmarrja ishte gjithëpërfshirëse, me panelistë si: kryetari i komunës së Gjilanit, Z. Lutfi Haziri, deputetë të Kuvendit të Kosovës, politikanë lokal, përfaqësues të tjerë nga bota akademike dhe nga organizatat lokale të shoqërisë civile.

Konferenca ‘Gratë për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë’

Më 2 prill 2019, në Prishtinë, kemi trajtuar në formë përmbajtësore rolin e gruas në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Konferenca ka gjeneruar debat dhe diskutime jashtëzakonisht produktive rreth temës në fjalë. Një fjalë hyrëse në konferencë ka mbajtur edhe Ambasadori Norvegjez në Kosovë, Z. Per Strand Sjaastad. Pjesëmarrja në konferencë ishte gjithëpërfshirëse, duke filluar nga përfaqësueset e të gjitha subjekteve politike në Kosovë, përfaqësueset e botës akademike dhe aktivistet e shoqërisë civile.



Trajnim në teknikat e intervistimit në terren dhe përdorimin e tabletave elektronik

Më 15 maj 2019, në Prishtinë, zhvilluam një trajnim tjetër lidhur me teknikat e intervistimit në terren dhe përdorimin e tabletëve elektronik, për të rritur më tej saktësinë dhe precizitetin në gjetje. Ky aktivitet ishte në përputhje me mbikëqyrjen e Universitetit të Oksfordit dhe programerëve lokal.

Zëri i Popullit rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Vëllimi II)

Nën organizimin e Institutit RIDEA, pavarësisht qëndrimeve diametralisht të kundërta rreth procesit të dialogut, janë mbledhur rreth një tryeze liderët kryesor të pushtetit dhe opozitës për të diskutuar për - Zërin e Popullit rreth “Finales së Madhe” ndërmjet Kosovës dhe Serbisë-. Në një tryezë të përbashkët janë mbledhur presidenti Thaçi, Z. Albin Kurti nga LVV, Z. Lutfi Haziri nga LDK, Z. Shpend Ahmeti, bashkëdrejtues i Delegacionit Shtetëror, profesorë nga Universiteti i Oksfordit, ambasadorë të ndryshëm nga vendet aleate të Kosovës, aktivistë të shoqërisë civile dhe përfaqësues nga bota akademike. Konferenca filloi me shpalosjen e gjetjeve të sondazhit nga Profesori Anthony Heath. Pas kësaj, fjala iu dha panelistëve të cilët i diskutuan detajisht këto gjetje.





Zona B: Labinot Greiçevci diskuton për “Zëri i Popullit rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Vëllimi II)”

Drejtori ekzekutiv i Institutit RIDEA, Dr.Labinot Greiçevci, ishte i ftuar në ‘Zona B’ së bashku me tre analistë, për të diskutuar mbi botimin e fundit të Institutit RIDEA, gjegjësisht rezultatet e studimit “Zëri i Popullit rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Vëllimi II)”. Gjatë këtij debati Z. Greiçevci ka zbuluar gjetjet e sondazhit dhe ka nënvizuar dallimet kryesore midis dy vëllimeve.

Rreth nesh:

Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) është një organizatë e pavarur, jofitimprurëse dhe e orientuar kah kërkimet, e specializuar dhe përkushtuar ndaj studimit dhe kuptimit të çështjeve Evropiane dhe të zhvillimit.

Projektet e saj financohen tërësisht nga dhurimet e individëve dhe të kompanive publike dhe private, për të bërë të mundur përmbushjen e misionit. Në të kaluarën, organizata ka hartuar dhe publikuar një sërë studimesh të politikave për aspekte kyçe të proceseve integruese evropiane dhe marrëdhënieve ndëretnike, çështjeve dhe politikave të jashtme, të së drejtës ndërkombëtare, politikave publike dhe sektorit të arsimit në Kosovë.



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10

Prishtinë, 10000 Republika e Kosovës

Email: info@ridea-ks.org

Web: www.ridea-ks.org

Tel: +383 38 746 206